



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 45 Prot

Tiranë, më 13/10/11

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit **MAGIC TOURS sh.p.k.**
Tiranë.

Adresa: **Bulevardi “Zogu i Parë, Nr.72, Veve Business Center, Tiranë**

VENDIM

Nr. 8, datë 13/10/11

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit **MAGIC TOURS sh.p.k. Tiranë.**

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe në mënyrë të veçantë të detyrimin të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të sipërm parashikohet: “Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë. Ndërsa në nenin 22 saktësohet përmbajtja e të dhënave që përpunoni, të cilat duhet t’i njoftoni tek Komisioneri.

Për zbatimin e këtij detyrimi nga ana e jonë, me shkresën nr. 3884 prot, datë 07/09/2010 ju është dërguar një informacion me shpjegimet se si do të plotësoni formularin e njoftimit të të dhënave personale që përpunoni, duke ju caktuar një afat për plotësimin e këtij detyrimi, datë 07/10/2010.

